



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 26-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26.01.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
2. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Shkelzen Hajdini, DSH
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DA
10. Safete Amerrlahu, DGJK
11. Burim Rrustemi, DSHPMSh
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica-LLugiqi
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se ju uroj një vit të mbarë dhe suksese. Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar Dhjetor 2023
3. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social
4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit
5. Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2023-2027
6. Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)

Pastaj tha se kemi edhe një pikë shtesë që e ka marr edhe rekomandimin e KPF-së, drejtori i DKA-së, Rasim Hasani, do ta bëjë propozimin dhe arsyetimin e kësaj pike.

Rasim Hasani, tha se në mbledhjen e kaluar Kuvendi ka marr vendim për çerdhen në Mgaure, mirëpo nga Ministria është kthyer në shqyrtim pas asnjë arsyes, unë kërkoh q e njëjta të anulohet dhe të vazhdojmë me proceduar tjera.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e kemi edhe një propozim për tërheqjen e një pike që është konsultuar edhe në KPF, ku arsyetimet që i ka dhënë ministria kemi pas dilema, drejtori Burim Rustemi, do ta jep një sqarim.

Burim Rustemi, tha se sa i përket planit për menaxhimin e mbeturinave në kemi pas dy rekomandime dhe njërin e kemi ndryshuar dhe plotësuar dhe rekomandimi tjetër ka ardh në KPF, Pasi plani është 2023-2027 dhe pas rekomandimeve të kryesuesit Daut Azemi, dhe asambleisti Arsim Jashari, jemi konsultuar edhe me Ministrinë dhe ata na kanë thënë që duhet të jetë 2024-2028, kërkojmë nga ana juaj që kjo pike të hiqet nga reni i ditës.

Arsim Jashari, tha se në dje në KPF e kemi diskutuar këtë plan dhe nuk mundet një plan me qenë prej vitit 2023 kur në jemi në vitin 2024. Ne i kemi dhënë rekomandimet tona dhe e mbështesim.

Daut Azemi, tha se pari propozoj që pika e 5-të e rendit të ditës Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2023-2027 të tërhiqet nga rendi i ditës me 26 vota për.

Pastaj te shtohet si pikë shtesë propozim Vendim për anulimin e vendimit 15 nr.353/01-69530 i datës 21.12.2023 caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim. Me 26 vota për aprovoi.

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar Dhjetor 2023
3. Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social
4. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit
5. Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional
6. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)

7. Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15 nr.353/01-69530 i datës 21.12.2023 caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes në Magure

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota per u aprovua rendi ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se pari ne emër te grupit te PDK-së, ju uroj vit te mbar, shëndet dhe suksese. Se parie kam një propozim për ekzekutivin qe ti vendosim disa kamera ne ato vende ku po hedhen mbeturina, pasi qe do ti ndihmonin edhe ekzekutivit edhe qytetarëve. Nëse ka mundësi me u bere kjo do te ishte e mirë. Kam disa kërkesa, e para ka të bëjë me banorët qe banojnë te ish mulliri “Bereqeti” kane mungesë te rrjetit te kanalizimit dhe pyesin? A ka mundësi ato familje me u lidh ne kanalizim. Tjetra kërkesa është e banorëve te banesave kolektive ku i kam vizituar dje aty ka defekt te kulmit, ka intervenuar komuna mirëpo nuk është evituar demi. Rruga Kosjkë Rubovc, Lipjan kur pritet te vazhdohet pjesa e mbetur. Kam disa kërkesa te këshillit të fshatit Kraishtë disa rrugica kanë mbet ne gjysme kur pritet te përfundohen, trotuari përballë shkollës mungon, aty nxënësit po rrezikohen kur pritet me u përfundua. Kërkesa e 3-te e këtij këshilli nëse ka mundësi qe KV Skënderbeu me i ndihmuar me mjete financiare. Kërkesa tjetër pse nuk po hiqen deponia e mbeturinave te shtegu i ecjes kur dihet q vendimi ka kalua ne kuvend, pse nuk janë larguar mbeturinat pse nuk ka filluar puna. Pyetje për DKRS-në, cilat kriteret nuk i ka plotësuar Betim Krasniqi, qe nuk është zgjedh sportisti i vitit, pasi qe e dimë qe ai është kampion i botes. Ose pse te paktën nuk e ka marr një mirënjohje.

Shahadije Dragaçina, tha se kërkesa e parë ka të bëjë me banorët e fshatit Bukovicë për asfaltimin e rrugës se tyre. Ata e kanë dërguar edhe një peticion për këtë rrugë, mirëpo nuk kanë marr kurrfarë përgjigje. Po ashtu ka ankesa nga banorët e Janjevës për punët qe po behën keq nga kontraktori rreth rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit. Çështja tjetër ka te bëjë me tollovinë qe po bëhet afër shkollës “Vëllezërit Frashri” . Tjetra projekti qe po behet për vazhdimin e sheshit dhe projekti i nënkalimit, a është bërë fizibiliteti para se te fillojnë punët dhe si do te duket ai plan?

Lulzim Rrustemi, tha se edhe unë ju uroj pune te mbar dhe suksese kuvendit, i kam disa kërkesa dhe pyetje, e para propozoj qe nga mjetet financiarë te mbetura te ndahen për ndërtimin e urës mbi lumin Sitnica ne Rufc. E dyta te vazhdohet ndërtimi i shtratit te lumit në Smallushë pjesa e dytë. Pyetje për drejtorinë e Infrastrukturës deri ku kane mbet procedurat pe renovimin e shtegut te ecjes ne Gadime deri ku janë

shkuar proceduar për këtë projekt. Rregullimi i hapësirave publike dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Poturovc çka ka ndodh me atë projekt.

Egzona Bytyqi, tha se kam do çështje për ti ngritur për drejtorin e shëndetësisë, e para, si shoqëri me përballur me një epidemi te gripit sezonal sa ka qen numri dhe si e kemi gjendjen si komune. Tjetra komuna e Lipjanit ka qenë përfituese e projektit zgjedhja e mjekut familjar, kërkoj sensibilizimin e te gjithëve për rëndësinë qe e ka ky proces. Pra ata qe kane llogari ne E Kosova, duhet me aplikuar online. Si pilot projekt ka me hasur edhe ne pengesa. Tjetra kemi fol shumë për kancerin e gjirit , muaji janar është muaji për sensibilizimin kancerit te gjirit dhe kërkoj qe te jeni ure lidhës për këta pacient për me ju dal në ndihme. Çështja tjetër regjistrimi i popullsisë ne nivel vendi si proces është shtyr, nëse ka mundësi me na njoftua çka ka ndodh me këtë proces.

Armedn Grajqevci, tha se kam një kërkesë për drejtorinë e Bujqësisë, për zhavorrimin e tokave bujqësore nëpër fshatra pasi qe është shumë e nevojshme për bujqit qe te zhavorrohen rrugët bujqësore ne mënyre qe te behet me lehte punimi i tokave. .

Ardit Cani, tha se se kam kërkesë për pastrimin e grykës se Baines, pasi qe aty është bërë një deponi ilegale. Po ashtu kërkoj nga drejtoria e inspektionit qe te gjobitet ata qe hedhin mbeturina. Po ashtu kërkoj qe te behet asfaltimi i rrugës qe dërgon te gryka e Bainsës. Kerkese tjetër te behet ndriçimi i rrugës Shalë Kleçkë, pasi qe është shume rruge e frekuentushme edhe pse është e nivelit qendror.

Alban Salihu, tha se ne fund te vitit ishim dëshmitar te dy organizimeve shume te dobëta te komune se Lipjanit, njeri për ceremoninë e sportistit te vitit qe nuk nderon as qytetarët e as sportistet, ku numri i pjesëmarrësve ka qen shume i vogël dhe salla nuk i ka plotësuar aspak kushtet. Organizimi i dytë ka të bëjë për festat e fund vitit dhe vendosja e shtëpizave në shesh, ku për këtë organizim janë nder 50 mijë euro sipas prononcimit te drejtoreshës së kulturës. Unë disa here kam dal në shesh dhe shtëpizat kane qen mbyll dhe nuk është zhvilluar asnjë aktivitet, pra shpenzim mjeteve pa arsytim.

Rinor Murati, tha se java që po lëmë pas na përcolli me një ndër ngjarjet më të trishta të kohës së fundit, ku një i ri dhunohet mizorisht e më pastaj fatkeqësisht s'iu rezistoi plagëve të marra. Lulzim Fejzullahu ishte fëmijë pa prindër të cilët i kishte të ndjerë. Raste si Lulëzimi, fatkeqësisht kemi shumë shpesh. Të gjithë bashkërisht duhet të angazhohemi maksimalisht në mënjanimin e plotë të këtyre dukurive. Për këtë jemi përgjegjës secili, qysh nga familja, shoqëria e komuniteti ku jetojmë me përgjegjësinë

më të madhe e bëjmë ne si përfaqësues të tyre. Konsideroj se arsimi është një ndër komponentët kryesorë në të cilën ,dukuritë negative në shkolla, si konsumimi i duhanit, alkoolit dhe të substancave tjera, mbartja e mjeteve të ftohta, janë disa nga problemet që kërkojnë zgjidhje, pra siguria në shkolla duhet të jetë prioritet. Për këtë konsideroj se secila shkollë duhet të funksionalizojë sa më parë Këshillat e Nxënësve dhe Këshillat e Prindërve, në mënyrë që secila problematikë dhe kërkesë të gjejë hapësirë më të lehtë për t'u adresuar dhe gjetur zgjidhje. Kam edhe disa kërkesa të tjera për të adresuar. Kërkesa e parë është nga banorët e fshatit Rubovc i Madh, që kërkojnë rregullimin urgjent të urës që shpie në fshatin Bablak të Ferizajt, urë e cila shkakton vërshimin në atë zonë dhe kësaj krijon pamundësinë e marrjes së rendimenteve bujqësore. Shpejtësia e veturave në rrugën Zylfie Gashi rrezikon banorët e asaj pjese dhe më të shumti fëmijët. Në takimin e organizuar nga Komiteti për Kulture Rini dhe Sport, drejtori i organizatës implementuese është zotuar se për 2023 do të krijojnë një komision i përbërë edhe nga anëtarët e Komitetit për Kulture Rini dhe Sport dhe nga zyrtarët nga Drejtoria për Kulture Rini dhe Sport dhe bashkërisht t'i vlerësojnë aplikimet për vullnetarët e vitit, gjë e cila nuk ndodhi. Personalisht të vlerësoj punën e organizatës në fjalë mirëpo sa i përket kësaj çështje kërkoj që të ketë një raportim në lidhje me këtë dhe këtë vit të kemi më shumë gjithë përfshirje dhe më shumë në të shumti meritokraci.

Fadil Spahiu, tha se unë kam një kërkesë për Drejtoratin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim nga familjet Shemsi, Naser dhe Bedri Krasniqi nga Smallusha Këto familje që banojnë në një lagje që lidhet me rrugën 12 qershori të fshatit Smallushë duke u bazuar në përgjegjësi përkuqjesjen dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimit nga ana e Drejtoratit kanë bërë kërkesë që të rregullohet rrjeti i kanalizimit në lagjen e tyre, sepse në këtë lagje është bllokuar kanalizimi më shumë se një muaj dhe ende nuk është bërë asnjë intervenim nga organet kompetente.

Besiana Sylja, tha se po e ngris si çështje problemin e daljes së ujës-jellës mbi rrugën në fshatin Gadime e Epërme, më saktësisht mbi rrugën Ekzodi. Faktikisht rrjedha e ujit mbi rrugë ka kohë që ka dal, por me gjasë aty mund të ketë ndonjë gyp që mund të jetë i dëmtuar, nga ku edhe del uji. Mirëpo së fundi ka shkaktuar probleme më të mëdha tash në sezonin e dimrit për shkak të ngricave që po bëhen. Faktikisht problemet e tilla në ujës-jellës, kanalizim ka qenë tejet të shpeshta edhe në vitin e kaluar. Ajo çfarë kërkoj nga Kabineti i drejtorive përkatëse dhe përgjegjëse është t'i evidentojmë problemet, të mbahen më shumë përgjegjësi në lidhje me punimet apo të mbikëqyren kompanitë që kontraktohen në mënyrë që punimet të ofrojnë punë cilësore dhe punë më shumë afatgjate.

Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se fillimisht ju uroj punë të marrë këtë sesionin pranveror, anëtarëve të Kuvendit.

Sa i përket mbeturinave drejtoria e inspektoratit tashmë është çdo ditë në terren edhe në inspektim të deponimeve ilegale është për momentin shumë e pamundur të vendosen kamera ose mini-kamera ashtu siç e propozuat. Janë duke pasuar edhe gjobat edhe tani në disa lokacione që janë inspektuar edhe po besojmë që nuk do të përsëriten më, por bashkëpunimi është i domosdoshëm prej gjithë juve. Te kanalizimi në Bujari edhe ne jemi duke e shqyrtuar kontratën e zgjerimit të rrjetit të kanalizimit, që vlen kjo edhe për Samullshë. Ndërsa te fshati Kraishtë ne e kemi aty edhe këshillin e fshatit dhe ne i kemi kushtuar shume vëmendje si me infrastrukturë dhe me ndërtimin e fushës së sportin, po ashtu ndërtimit të fushe së hapur, pasi që janë një fshat shumë aktiv për sport. Po ashtu edhe trotuari është i nevojshëm i cili me kohe do të realizohet. KV Skënderbeu një klub i suksesshëm në gara evropiane dhe mbështesja nga ana e komune nuk ka munguar asnjëherë. Lokacioni për kompaninë "Pastrimi" është çështje e mbrëmshme e kompanisë, pasi që kompania është çështje regjionale. Sportisti i vitit ka qenë konkursi u hapur për klubet sportive dhe ata i kanë dhënë propozimet e tyre. Ka qenë një ceremoni e organizuar shpejtë. Parkingu i qytetit projekti ka qenë një kat nga fillimi asnjëherë nuk është thënë që do të jete dy kat, të cilin mund ta shihni është i publikuar si do të doket. Urat në Rufe dhe në Smaullshë nuk kemi mujt ti përfundojmë por këtë vit do të përfundojnë si projekte. Mbjellja e drunjëve dekorativ ka dështuar kontrata. Sa i përket gripit sezonal edhe ne si komune jemi prekur por gjendja është mire dhe është menaxhuar mirë. Sa i përket regjistrimit të popullsisë ka dështuar për shkak se nuk kanë mujt me u përgatite Ministria. Në Lipjan do ta mbulojmë me aplikues të fshatrave të tjera. Çështja e zhavorrimit të rrugëve bujqësore do procedohet sivjet. Ndriçimi Magure Kleqke çështje e nivelit qendror. Shtëpizat është projekt 3 vjeçar, ka pas aktivitete por ka qenë me zbehte sivjet por shtëpizat kanë qenë të hapura, 50 mijë euro ka kushtuar për 3 vite projekti. Ngjarja e fundit në Podujeve na ka tronditur të gjithëve. Ndërsa planin për rini e monitorin DKRS-ja, organizata në fjalë i kryen raportimet të DRKS-ja. Ka pengesa me ujësjellësin kemi kontraktuar kompaninë e pastrimit dhe do të rregullohet shumë shpejt në Gadime dhe vendet tjera.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju kisha lut që ta respektoni dhe dëgjoni njeri tjetrin kur bisedon ta paken keni konsiderate për njeri tjetrin.

Arim Jashari, tha se e falënderoj nënkryetarin për elaborimin dhe përgjigjet, por unë nuk kesh kundër përzgjedhjes së trajnerit të Skënderbeut, por e kontestova organizimin e sportistit të vitit i cili ka mujt me qenë ma i mire. Komuna e Lipjanit nuk

ka ekip te badibildingut dhe ai djali është detyruar vet te aplikoj. Un jam kundër një sportisti ju ka bere e pa drejt, i cili është kampion evropian. Është te paktën një shenje falënderimi për të.

Bashkim Budakova, tha se për rrugën Lipjan - Kojskë Rubovc dhe urën te lumi ne fshatin Rubovc qe është një problem i kamotshëm për ata qytetar, nuk morëm përgjigje

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës, tha se rruga Lipjan Rubovc, kemi pas një projekt bashkë me Ministrinë por nuk kemi arrit me përfundua për shkak te tërheqjes se mjeteve nga ana e Ministrisë, ndërsa urën ne Rubovc mund ta planifikojmë ne buxhet. Sa i përket Betimit ne e falënderojmë për punën qe e ka bërë.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 25-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 25 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 21 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 25-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar Dhjetor 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se raporti i buxhetit janar-dhjetor 2023 për komunën e Lipjanit kemi dilema dhe specifika të veçanta të cilat tregojnë se buxheti megjithatë ka vërejtje shumë dhe ka një shpenzim jo të akomodum mirë. Te fondet burimore, te buxheti dhe shpenzimet sipas fondeve burimore, te granti qeveritar, kanë mbetë shumë mjete pa u shfrytëzuar ku 600 mijë euro janë suficit këto mjete me nuk kthehen në komunën e Lipjanit. Te donacionet edhe këtu ka shpenzime te pa realizuara megjithatë, realizimi i përqindjes është i mirë, por këto mjete që kanë mbetë pa u shpenzua janë shfrytëzua 99%. Investimet kapitale ka mbetë edhe një shumë e madhe pa u shfrytëzuar. Buxheti dhe shpenzimi nga granti qeveritar, janë shpenzua njëqind për qind. Buxheti dhe shpenzimet nga të hyra vetanake, do t'i përmendi vetëm ato që kanë shpenzim pak më të vogël subvencionet kanë mbetë edhe 60 mijë euro pa shpenzuar. Buxheti dhe shpenzimet nga donatorët, kanë mbete te pa shpenzuar një përqindje e buxhetit. Gjithsej te buxheti nga donatorët, ka shpenzim të vogël në të gjitha kategoritë. Cilat projekte ka dështua Komuna e Lipjanit në vitin dy 2023, unë do t'i përmend vetëm disa të cilat kanë dështuar, e që janë nga gradët e qeveritarë Ndërtimi i shtratit të lumit Smallushë , Shtigjet ecjes në Gadime, Rikonstruktimit rrugëve së shkollës në Dobrojë të Madhe dhe disa rrugica të tjera. Blerja e aparateve biokimike dhe hematologjike në QKMF, Rregullimi i shtretërve të lumit e te tjera. Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Lipjan, e kemi një shpenzim të të hyrat vetanake, të bartura që kërkojnë sqarim prej drejtorit, kush i ka shpenzua në emër të Kodit për Shtëpi të Kulturës. Tek karburantet, veturat po ashtu kemi një shpenzim shume te madh, po ashtu edhe te telefonja. Dhe ato qe i shpenzoni shkruani.

Besiana Syla, tha se shihet në bazë të raportit, buxheti i komunës së Lipjanit është i shpenzuar me 91%. Por kjo shifër nuk është e saktë sepse kur dihet se komuna ka tejkalim të hyrave vetanake mbi një milion euro, çka do të thotë se të hyrat vetanake të realizuara janë mbi 3 milion euro, kur buxhetit i shtohet edhe donacioni i cili është i realizuar gjatë vitit 2023 mbi një milion euro e që në total donacionet janë mbi 3 milion euro. Atëherë buxheti nuk është shpenzuar me 83 %, e jo siç është në raport me 99% Kur i shikojmë burimet financiare Burimet e financimit shohim se granti qeveritar është shpenzuar me 96%, mirëpo kemi suficit prej 64% Këto mjete janë bartë në buxhetin qendror dhe komuna nuk mund t'i shfrytëzojë. Atëherë, unë kam një pyetje për drejtorin pse Komuna e Lipjanit drejtor është ka shkuar suficit?, pse drejtor nuk është bërë i ridestinimi i mjeteve?. Ndërsa tek mallrat dhe shërbimet kemi suficit mbi 42 mijë euro, gjithashtu suficit edhe tek subvencionet dhe transferet me vlerë mbi 50 mijë euro Gjatë analizë të shpenzimeve kapitale shohim se disa projekte edhe pse janë aprovua në këto projekte as që ka fillua implementimi i tyre dhe ato janë: vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit në fshatin Gadime, konstruktimi i rrugës së

shkollës në Dobrajë të Madhe dhe rrugica tjera, blerja e aparateve biokimike dhe hematologjike me QTMF në Lipjan. Të gjitha këto projekte shuma e tyre është suficit. Pse nuk janë realizua këto projekte dhe ku është problemi i këtyre projekteve? Gjithashtu, kemi mbetjet nga projektet e implementuara. Kjo tregon se planifikimet e investimeve bëhen pa kurrë çfarë analize të mirëfilltë. Te kodi i projektit ndërtimi i qendrës së re të kulturës, siç po shihet kemi shpenzim, por projekti as që ka fillua mu ndërtua. Pse drejtor nuk ka fillua ky projekt mu ndërtua? Shpenzim jo i kënaqshëm është edhe donacione të bartura në vlerën mbi 1 milion euro. Nga pasqyra e ekzekutimit të thesarit shihet se komuna ka hyrë në obligim në pa zotim të mjeteve, për rrugën Gjilan-Gadime, ndërtimi i infrastrukturës së varrezave Hallaç i Vogël - Krojmir e Risinovc dhe Aneks ndërtimi i shkollës Glllogovc. Atëherë, drejtor pse komuna e Lipjanit ka hy në obligim pa zotim të mjeteve, kur ju e dini që është në kundërshtim me Ligjin e Financave dhe Përgjegjësitë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju kisha lutë të keni kujdes mos të dezinformoni me fjalimet e juaja. E dyta, merreni lexoni mirë raportet, nëse nuk ia shkruan dikush tjetër, lexoni mirë., mos bëni kritika të pavenda, mundi me bo politikë, por jo tu dezinformua.

Shahadije Dragaçina, tha se raporti njëvjeçar i shpenzimeve dhe të hyrave për vitin 2023 nëse analizon vetëm tek investimet kapitale, këtë raport edhe atë të vitit 2022 shohim se ka menaxhim jo të mirë të buxhetit të kjo kategori. Në vitin 2022 dhe në vitin e kaluar, kryetari, bashkë me drejtuesit e drejtorive vazhdojnë të dështojnë bashkërisht në këtë drejtim, pasi që deri në muajin shtator për dy vite buxheti për investime kapitale është shpenzuar 30%, pra për nëntë muaj vetëm 30% të buxhetit për këtë kategori, ndërsa në tre mujorin e fundit shpenzimet rezultojnë me mbi 70 %. Ky menaxhim tregon për një planifikim mjaft të dobët, joadekuat e të keq, që e bën edhe të shpallur një kampion. Janë përruruar shumë projekte, por moti ka qenë jashtëzakonisht i keq dhe ato punime që janë bërë nuk mund të rezultojnë, vlerësoj, me ndonjë cilësi. Tjetra problemi që është i papranueshëm dhe shqetësues është fakti se rreth 600 mijë euro nga granti qeveritar i ka çuar në suficit. Kryetari i Komunës për vitin 2023, flet për mos përkrahjen e investime nga niveli qendror, kurse mjetet e shumta i shkojnë në Suficit për çdo vit për shkak të menaxhimit të dobët në investime publike. Në tëra raport të shpenzimeve ajo që më ra në sy ishte edhe shuma prej rreth pesë mijë euro e shpenzuar për informim publik. Ndërsa kërkoj sqarim edhe për shpenzimin 14 mijë euro për anëtarësim, dëshiroj të di se për çfarë anëtarësimi bëhet fjalë, se është një shumë goxha e madhe. Sqarim shtesë kërkoj, sepse e kam e kam të paqartë edhe çështjen e shpenzimeve të mijë eurove për dreka zyrtare dhe furnizim

me ushqim edhe pije ku prinë Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës. Unë e kam të paqartë se kaq shume mjete për telefoni mobile, nga kush janë shpenzuar dhe si janë shpenzuar.

Albiona Tasholi, tha se komuna jonë ka përfunduar një vit me një shpenzim jashtëzakonisht të mire, duke arritur të përdorë mbi 91 % te buxhetit. Megjithatë, sfidat si mos ridesteni i mjeteve, pengesat me OSHP dhe mos rishikimi të buxhetit kanë qenë ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë proces, mirëpo ajo çka është shumë e rëndësishme te granti qeveritar është i shpenzuar në masën 96 % Gjithashtu, përveç kësaj, ky shpenzim prej kësaj për qindje tregon aftësinë për menaxhim të mirë të buxhetit përkrahur nga MAPL-së dhe nga Instituti të GAP-it. Andaj e përgëzoj Komunën e Lipjanit për arritjen e përgjegjësin njëqind për transparencë.

Alban Salihu, tha se fillimisht dua të vlerësoj nga këto fjalimet e asambleistëve tonë, por edhe asamblistit të opozitës z. Rrustemi, për gjetjet serioze që i patën në shpenzimet e buxhetit dhe po ashtu e ftoj Komunën që të merret me këtë gjetje. Kam vetëm një pyetje për drejtorin e financave: a mund ta konfirmojë këtë publikisht që a mund të deklarohet publikisht që nuk është kryer ndonjë pagesë të investimet kapitale për ndonjë punë që nuk është kryer? Pra, është kryer pagesa dhe punët pritet të kryhen në ditët ose javët në vazhdim.

Besiana Sylja, tha se kur çfarë dezinformate nuk kam bërë lidhje me raportin, se kjo unë e mora si akuzë, kështu janë shifrat ku i keni pasë secili prej juve, edhe i kam marrë, edhe i kam lexua. Me thënë që ky raport është mirë edhe është shpenzua një buxhet me 96%, atëherë edhe komuna e Lipjanit i ka humbë 600 mijë euro a o kjo disinformatë. Komunës shumë mjete i kanë shkuar suficit. Bëni punë të mira, unë kurrë s'ju kritikoj, herë se s'kam çka me ju kritikua. Atëherë unë i pata disa pyetje. Keni pasë mundësim me bërë ridestiminin e mjeteve pse nuk e keni bere. Jo dini mirë drejtor sidomos që ka pasë rregull me ligj, sipas nenit tridhjetë të Ligjit të Financave, ka mund me bë rideshmim i mjeteve edhe s'e keni bere. Kush problemi është faji të opozita?

Daut Azemi, tha se ju kisha lutë secilit prej vendit të mos flisni, e keni mundësinë me folë sa herë doni, ja japim fjalën, por mos flisni prej vendit. Në fjalimin parë që patët thatë se ky raport nuk është real, nuk është i saktë, në momentin që thua ti këto janë dezinformata, sepse raporti është raport, që diçka tjetër po thua tash, por thua nuk është bo shpenzimi i mirë, është çështje që ti e vlerëson a është i mirë a i keq, ai është mendimi yt. Por, nëse thua nuk është raporti i saktë, nuk janë pasqyrua gjërat të saktë, ajo është dezinformatë, sepse ky është raporti i saktë. Hajde tregoni çka keni

bërë ju për Lipjanin, asnjë projekt s'e keni prurë as deputeti juaj, as askush. Është mirë dhe na me ju lëvdua juve se e keni prurë një projekt në Lipjan.

Latif Ramadani, tha se kam dhënë një herë hajde kur do në zyrë, edhe bisedon, dhe ta shpjegoj se nuk është marrë mos me ditë. Qe don me ardhë dhe me këqyrë çka është shpenzim, për çka o bë, qysh bëhet një raport, është lehtë me bë këtë punë. A e drejtë edhe ridestinimin? E kena kryer ridestinimin, e ke votua edhe ti, por është diçka që të harron. Ministria nuk na ka lejuar ridestinimin e kena ba në këtë Kuvend edhe është votua me shumicë të votave gati absolute edhe e kemi dërgua në Ministri. Ministria është kompetente për me lejua edhe me i aloku ato mjetet në ridestininim, prej mbetjeve që janë krye projektet, për me krye do projekte të reja për të mirën e qytetarëve, Luli e përmendi do shpenzime që kanë qenë edhe pa parkun edhe parkingun që ky lidhet një projekt edhe ambulancën. Organizatë më kredibile për me vlerësua shpenzimin e buxhetit se Zyra e Drejtorit Gjeneral nuk di që ka në këto. Edhe na rikëqyrje njëmbëdhjetë vite Zyra e Auditorit Gjeneral, Komunën e Lipjanit e vlerëson me notën më të lartë raport i auditimit. Është për Asociacionin e Komunave që jemi anëtarë dhe i paguhet anëtarësia që e ka punë secila komunë edhe për më zyrën. Ata qe nuk e kanë krye punën si duhet na ja kemi ndërpre punën dhe te shkojnë mjetet suficit Le të shkojnë suficit, le të shkojnë Qeverisë, Me vendim për vendimet gjyqësore që thotë pse është pagua kjo dhe pse është pagua, po përnjëmend bre duhet me lexu veç këqyre te lista e përmbarimeve për vendime gjyqësore, këqyre ku janë marrë paratë, për shtëpinë e kulturës Luli po më duket e përmendi dy vendime gjyqësore domethënë janë prej qasej që është regjistrua si shpenzim, por i ka marrë përmbaruesi.

Besiana Sylaj, tha se unë nuk e kisha akuzua komunën, por nëse i shkuar suficit ndoshta diku rreth 30 mijë euro, i ke hup komuna. Po, është një shumë goxha e madhe, domethënë është mbi gjysmë milionë euro, kur unë e di që problemet e qytetarëve të Komunës së Lipjanit janë aq të mëdha sa që qytetarët nuk kanë rrugë nuk kanë ndoshta trotuar dhe këto mjete me shkuar suficit është jo e drejtë.

Arsim Jashari, tha se unë fillimisht, kisha nderuar e gjuhën parlamentare dhe duhet me respektua njëri-tjetrin, se këtu na kemi ardh për të mirë qytetarë dhe na kanë bërë qytetarët dhe është mirë këtu me dominua argumenti dhe e vërteta e faktit dhe jo të gjeja gjëra, kështu që të arrijmë sot kushdo që ka të drejtën e vet. Unë e kam veç në dy pyetje të shkurtra. Më sa kuptohet qiky suficit, a është domethënë edhe faji që nuk është nuk u kthye ridestininimi me kohë? E dyta, po më intereson, nëse dikush lun me shifra është jo e drejtë pasi qe është raport zyrtarë dhe duhet me pasë kujdes.

Latif Ramadani, raporti është shumë real, shumë i vërtetë dhe shumë transparent për secilin shpenzim që është bërë. Rishikimi dhe ridestnimi kanë ndikua se janë mbet këto mjete pasi që nuk janë krye kontratat me projekte të caktuna e që këna pas drejt me i ridestinu për projektet të reja. Disa kontrata janë shkëputë .

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken në vazhdim

III

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim plotësisht propozim-vendimin për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë profitabile të përfituesve të banimit social. Ky propozim është i strukturuar me kujdes, duke përcaktuar një periudhë kohore nga data 1 janar 2024 deri me datën 31 dhjetor 2024 në një shumë prej njëzet e katër mijë euro. Në një kohë kur sfidat janë të shumta, vendimet e tilla ndihmojnë në lehtësimin e barrës financiare, andaj besojmë se ky vendim do të reflektojë përpjekjet tona të përbashkëta për të ndihmuar dhe për të përmirësuar jetën e qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se sapo kemi hi në Kuvend edhe ne kemi probleme teknike, nuk është në rregull, sidoqoftë njëherë e mirë me u rregullua edhe zërimi, edhe klima edhe ne kur të vijmë në vend të punës me pas një ambient Ky kuvend është i asamblistëve dhe asamblistët kanë të drejtë me thënë gjithçka. Nëse ju keni me demantu muni me dalë, është foltorja. Sa i përket pikës për të cilën po diskutojmë jo si grup i asamblesëve, natyrisht që sikur çdo herë e përkrahim edhe këtë radhe ë lirimi nga pagesa për kategoritë ë sociale, mirëpo një pyetje e kam drejtor. A ka nga këto kategori që i kanë marrë nga tridhjetë e një përfitues, ndonjë i cili e ka përmirësua gjendjen ekonomike, a ka ndonjë komision i cili i verifikon apo mbikëqyrë, në mënyrë që në përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike mirë lirua rrugë atyre të cilëve të presin, e që kemi shumë të tjerë të cilët kanë shumë nevojë me pasë edhe ata një banesë nga komuna, e që e di që është një listë shumë e gjatë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha, unë çdo here kam ndërhyre që të respektoni njeri tjetrin dhe mos ndërhyri nga vendi, por ju prape po ndërhyri.

Besiana Sylja, tha se meqenëse po bëhet propozimi për lirim nga qiraja joprofitabile të përfituesit me banim social, unë i kam disa pyetje për drejtoreshën. Kush janë të përfituesit, sipas kriterëve? Çfarë hapa ka ndërmarrë komuna që këta përfitues ta zgjedhin statusin e tyre të banimit dhe sa e ka menduar komuna ta ndajë ndonjë banim për rastet që mund të pësojnë nga ndonjë fatkeqësi, si për shembull katastrofat, dëmet nga faktori njeri apo edhe duke përfshirë edhe dhunën në familje.

Fadil Spahiu, tha se Propozon vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë jo profitabile të këtyre familjeve përfituese të banimit social, që janë të vendosura në 31 banesa me anë të secilit krijohet lehtësira financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike, si dhe situatës së rëndë ekonomike në vend. Si pasojë, ngritës i çmimeve të lartë mendoj se është i nevojshëm dhe e mbështetës.

Lulzim Rrustemi, tha se kisha pas qejf me pas një raport para se me marrë vendimin, a po e marrim vendimin po propozoj për vitin tjetër. Është mirë këto familje që po i ndihmojnë a janë të gjitha familjet që kanë nevojë. Mirë është me i ndihmua, por është mirë gjithmonë kur dikujt i jep ndihmë dhe ia zgjat dore me pas një raport. Duhet me pasë një raport. A janë rritur fëmijët? A ka sigurua dikush punë? A ka ndërrua statusi social i fëmijës apo i familjeve? Plus ajo tjetër e kam pasë propozu drejtorit edhe më herët, familjet që kanë fëmijë, që kanë moshën tetëmbëdhjetë vjeçare të rritur në përpjetë, komuna është dashtë me kanë inovative, edhe kanë një herë një të tjera ata djem e vajza, edhe me ja ua siguru një punë praktike, e jo të rrinë veten që këtë banesë po e fitojnë, nuk po ia fol kërkosh, po u më punë me vet, po meritojnë me pasë. Po, është një kulturë e punës, është një kulturë e fitimit të asaj që shteti ta jep.

Shkelzen Hajdini, tha se nëse vazhdojmë kështu, bashkë na e avancojmë edhe më tutje jo vetëm këtë proces, por të gjitha proceset, unë pajtohem dhe konsideroj që që do të mirrem parasysh edhe propozimet e juaja rreth avancimit dhe përmirësimit të gjendjes ekonomike të familjarëve, ishte një pyetje. Unë nuk kam informacion, e di që kjo punë përcillet, por po të kishte informacion, sigurisht do të vinte në Kuvend të të raportohet, por unë do të deklarohej para juve që nuk kam informacion. Një pyetje tjetër ishte që të sigurohet strehimi në rast të fatkeqësive natyrore dhunës në familje për informacion të juaj si si shtëpi e Kuvendit, na veç kemi një strehimore këtu për këto nevoja, kemi edhe marrëveshje me me organizatat e shoqërisë civile përgjegjëse që kanë të themeluara dhe menaxhojnë strehimoret si për dhunë në familje, si për fëmijë të braktisur e kështu me radhë. Megjithatë, duhet të pajtohem me diçka që ende jo

vetëm komuna e Lipjanit, po asnjë komunë nuk plotëson komplet nevojat për këto kategori, që do të ishte mirë po konsideroj që komunat janë ka avancoohen në këtë drejtim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit që të përmirësohen dhe korrigjohen gabimet teknike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 26 vota për aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë fillimisht dua me falënderuar komisionin, i cili e ka përzgjedhë dhe e ka bërë një punë të jashtëzakonshme, se nuk ka qenë lehtë të nëpër çdo fshat me organizua. Shpresoj që këto këshilla e fshatra me të vërtetë janë pranë kërkesave të qytetarë me të vërtetë janë dhe te epin kontribut secili për lokalitet dhe të bashkëpunojnë, komuna do të zhvillojë bashkëpunim me këshillat e fshatrave, bazuar në detyra të cilat transferohen atyre për t'i plotësuar, në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më i efektshëm. Disa prej detyrave kryesore që imponojnë këshillat e fshatrave, sipas rregullores në fuqi, përfshijnë: organizimin e takimeve në banor, banorët e fshatrave, zonave urbane dhe vendbanimeve për të diskutuar problemet dhe zgjidhur problem me karakter publik; paraqitjen e propozimit të qytetarëve në projektbuxhet në mënyrë që të aprovohet nga komuna dhe të inkorporohen në plan zhvillimor të komunës. Unë personalisht po ju komentoj të gjithë atyre këshillat e fshatrave, kryetarët e këshillat e fshatrave që nuk kanë përfaqësua në kuvendin komunal, unë ia kam dërgua kanë një email, po jua kam dërgu një mesazh për bashkëpunim. Ne si anëtar i kuvendit të grupit të asamblesë së PDK-së na e mbështet me këtë propozim-vendim dhe doemos t'ua përkrahim

Fadil Spahiu, tha se meqë qëllimi i këtij propozim-vendimi është për subvencionimin, përkatësisht ofrimin e mbështetjes financiare për punën dhe aktivitetet e zhvilluara të kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, e

mbështes këtë propozim-vendim, sepse kryetarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, përveç mbledhjeve të mbajtura dhe organizimit të aktiviteteve të tjera lokale në lokalitetet e tyre, kanë bërë edhe interpretimin e kërkesave, ankesave dhe propozimeve dhe projekteve të ndryshme të banorëve tek ekzekutivi. Këto aktivitete i kanë bërë me mjetet financiare të tyre dhe njëkohësisht i falënderoj për të gjithë kontributin e dhënë për këtë.

Rinor Murati, tha se, ky vendim për subvencionim të këshillave të fshatrave është një vendim mjaft i duhur dhe i nevojshëm dhe njëkohësisht edhe një motiv shtesë për ato këshilla që të angazhohen maksimalisht për nevojat dhe kërkesat që banorët e lokaliteteve të tyre i kanë.

Lulzim Rrustemi, tha se përkrahë këtë propozim vendim mirëpo mënyra se si është zhvillua procedura me bërë pagesën si subvencion, që e keni shkrua 500 euro për kryetarë të fshatit të lagjeve urbane, është diskutabile. Kryetarët e këshillave të fshatrave për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës sipas rregullores, kompensohen një kompensim të mëditjeve të anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, baza e kompensimit, dhe kryetarët e fshatrave kompensohen për 6 takime brenda vitit. Tash, e duhet me përcaktua apo pagua një mëditje. Për takimet që ata duhet me i plotësua në procesverbale që i kanë mbajte e i kanë brenda vitit, a do të paguani për vitin 2023 apo 2024. Domethënë, tash duhet me zgjidhë, a po jua epim mëditje a subvencion. Ne kemi obligime prej tyre për punën që e bëjmë për angazhimin. Nuk janë angazhime të vogla, ju e dini, ka punë shumë edhe ka obligim meritojnë një kompensim. Edhe për këtë kompensim minimal duhet me caktua formën qysh me i nda këto mjete. Jo ne këtë formë.

Egzona Bytyqi, tha se unë e mbështes këtë propozim vendim por ne veçanti e falënderoj kryetarin e këshillit të Qylages që ka bërë një punë shumë të mirë dhe ka pas një angazhim shumë të madh.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se faleminderit të gjithëve që e mbështet Luli plotësisht ka të drejtë, por rregulloret që kanë qenë në fuqi nuk kemi mujt me i implementua, edhe kanë rreth poshtë me hyrjen në fuqi të Ligjit të pagave. Sistemi ynë qeverisës nuk e njeh nivelin e tretë qeverisës, domethënë kryetarët e fshatrave nuk janë në nivel vendimmarrës ose qeverisës, domethënë përderisa obligohen komunat me i zgjedhë kryetarët e fshatrave, duke u bazua në ngarkesat që ne kërkojmë prej tyre për me i përcjellë shqetësimet e qytetarëve tek ne, kemi dashtë me i motivua për punën dhe angazhimin e tyre që e bëjmë, domethënë është subvencionim, nuk është as pagë, as mëditje, as asgjë plotësisht pajtohem mirëpo është

një motiv shtesë për punën që ata e bëjnë. Duke ditë faktin që edhe komisioni që i ka zgjedhë ata, ende nuk është paguar. Jo na ë realisht jemi tu bë përpjekje me zgjedhë këtë çështje, për shkak se është ngarkesë edhe për neve, jo vetëm komisioni për zgjedhjen e kryetares të fshatrave, por edhe komisionet tjera të rëndësishme që ende nuk kemi arrit, Domethënë kjo nuk është mëditje, nuk është pagë, është subvencionim. Dhe një motiv shtesë për kryetarët e fshatrave që realisht bëjnë një punë edhe kanë një ngarkesë ndoshta të padrejtë në raport me kërkesat.

Ganimete Qriqi, tha se edhe unë pajtona në me të gjithë parafolësit dhe sigurisht se do ta votoj do ta përkrah në ndarjen e kësaj shume për këshillat e fshatra, kryetarë të këshillave të fshatra. Por shpresoj që herëve tjera, pas tyre zgjedhje ta kemi po parasysh këta, që ka me kanë përqindja gjinorë më ndryshe në këto këshilla të fshatrave te ketë me shumë femra.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi, DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si Grup i Asamblesë do të mbështesim këtë propozim-vendim. Është mirë me pasë bashkëpunim me komunat tjera. Ajo sa kisha kërkuar e duke u bazuar gjithmonë me kërkesën që e tha Doktoresha Egzona, nëse ka mundësi ta bëj një bashkëpunim të veçantë me komunën e Drenasit për arsye shëndetësore, te ambulancës që e ka Komorani dhe që i lidhe ato fshatra . Përndryshe, na e mbështesni edhe pse edhe pse brena këtij plani ka gjana që pak ka me na dëmtua në aspektin e arsimit. Është një ide e mirë për bashkëpunimi. Po shpresoj edhe te problemin nacional të qenë endacak këto komuna të mund ta gjejnë një gjuhë të përbashkët, për mënyrën e evitua se me të vërtetë është dukuri e keqe, kështu që ne do e mbështesim këtë propozim.

Fadil Spahiu, tha se sa i përket propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional, e cila behet ne te mirën e qytetarëve të komunës së Lipjanit dhe unë e mbështes si propozim

Shahadije Bikliqi, tha se e kam vetëm një pyetje për me sqarua se për interesin e shumë banorëve, kanë me këtë kanë mëndu që me një janar lëshohet linja e transportit, veç me ua sqarua banorëve me ditë se kur pritet me u leshu për qarkullim kjo linjë e transportit Prishtinë QMI, Janjevë.

Rexhep Rexhepi, tha se Prishtina ka bërë këtë kërkesë dhe iniciativën, ne ju kemi bashkëngjitë. Ata e kanë çfarë, nuk kanë dashtë me shti Drenasin apo jo, Ne mujme me bo një propozim për Drenasin? ne veç mujm me propozua, por ne nuk jemi ata që vendosim. Tek transporti për Janjevë, prapë po them, ne jemi vetëm pjesë e e marrëveshjes 6 komuna që janë që kane miratuar ne kuvend.

Arsim Jashari, tha se veç një sqarim, nuk thashë pse s'e keni shti Drenasin edhe për arsyen që e tregojmë që e ka diskutua disa herë doktoresha Egzona, mos edhe ka punuar në atë pjesë, është mire që me pas na një bashkëpunim me Drenasin. Ne e përkrahim këtë propozim.

Albiona Tasholli, tha se deri tash kam tu folë për edukatë, dhe partitë opozitare, në Kuvend, nuk është edukatë nëse nënshkruajmë kur palët nuk janë prezentë. Përkatësisht, Shahadija vetëm sa nënshkroi për Albanin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se me këtë çështje merremi bashkë me sektorin e kuvendit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi, DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne do mbështesim me këtë iniciativë, është iniciativë e qëlluar Ajo çka kërkojmë ne si grup i asamblesë së PDK-së që të vlejné meritokracia, le t'i marrin ato pajisje dhe serra njerëz që punojné edhe me të vërtetë që kontribuojné,

e jo me marrë njerëz që vendosin sikur në vend të garazhit që të shfrytëzojnë, e kemi shumë raste. Kështu që grupi i Asamblesë së PDK-së do e mbështesë me këtë iniciativë.

Besiana Sylja, tha se para se mu votua kisha dashtë me kuptua cilat janë benefitet apo avantazhet e komunës për subvencionim a ia vlen komuna të mbështesë organizata dhe a ke a kemi partnerë kur dihet se organizatat janë ato që sjellin benefitet dhe komuna inkurajojnë për interesat e tyre në asnjë mënyrë në përmbushje të programeve apo misioneve të tyre. Kjo po ngritët për faktin se për ta votuar duhet të dinë më shumë se çka synohet të arrihet, a ka mbulueshmëri të entiteteve apo komuniteteve, meqë me të vërtetë ka nevojë të mbulohen në aspektin socio-ekonomik.

Fadil Spahiu, tha se Siç edhe kam thënë kur është bërë edhe ndarja e pjesë së parmë, meqë qëllimi i ndarjes së këtyre mjeteve është bërë për jetesën e qëndrueshme dhe gjenerimin e të ardhurave përmes moto-kultivatorëve dhe serrave, dhe se përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e komunës së Lipjanit e mbështes këtë propozim.

Rexhep Rexhepi, tha se aspektit benefit, përmenda të normal që ka benefit, për arsye që na e kemi pasë vetëm vitin 2023 shumë grande, dhe ka pas përfitime prej organizatave. Realisht kanë përfituar prapë për afërsisht 900 fermerë, Tash, a mund me shku e keq vendin e duhur, e kemi qëllim edhe synim me shkua ne vendin e duhur.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për anulimin e vendimit 15 nr.353/01-69530 i datës 21.12.2023 caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, nga DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne kur ka ardh propozim vendimi për çerdhe e kemi përkrahë se e dimë rëndësinë e çerdhes. Por unë sinqerisht po kam pak problem me me i kuptua këto problemet me ministrinë që po kthejnë këto vendime dhe mbrapa pa pasë një bazë ligjore si duhet. Nëse jeni të sigurt që është gabim, unë jua kisha

dërgua një ankesë. Janë zyre të ankesave që nuk është në rregull kjo punë. Është një problem shumë i madh dhe nuk është në rregull, kështu mu maltretua qytetarët, e mu maltreto edhe Kuvendi edhe ekzekutivi me gjatë. Kështu që ne e mbështesim, do e votojmë për me tërheqje këtë vendim, do e mbështesim si PDK, po megjithatë.

Rasim Hasani, tha se unë në qëllim e lexova informacionin nga Drejtorja e Urbanizmit për që të përcjellë. E lexova komplet, që është në harta zonale, është e destinuar për ndërtimin për shërbime arsimore. Në të njëjtën kohë prona është e komunës, titullar është komuna dhe gjithashtu e kemi kryer edhe formalitetin në kadastër me e caktua si parcelë me nda. Nuk kemi arsytim. Unë qetash me procedua e marr lejen që ti, si drejtori i arsimit, me i pasë paret qetash si kuvend, me e marrim lejen edhe fillojmë me ndërtua. Çka ndodh? Qysh kthehen shkresat? Në anën tjetër është afati ligjor tre ditor që nëse akti nuk rishqyrtohet ose nuk anulohet, atëherë është një minus për Kuvendin. Kjo është arsyeja në pamundësi për me gjetë zgjidhje prej kësaj shtate, e kemi propozua me anulua si vendim edhe të shohim tutje.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12:45.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi